



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 104/02-5703/22
Kaçanik, 05.03.2022

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e II (dytë) Solemne e Kuvendit të Komunës për vitin 2022, mbajtur me 05 Mars 2022. Mbledhja u mbajt në sallën e kuvendit të komunës, në katin e tretë, në ditën e shtunë, me fillim pune në ora 9:00.

Pjesëmarrës të kësaj mbledhje nga KK ishin 27 anëtarët-të gjithë.

Nga Ekzekutivi i Komunës ishin: Kryetari i Komunës Besim Ilazi, Nënkyetari i Komunës, Sabedin Vishi, drejtorët e drejtive (Qamil Stagova, Zahir Doda, Bahri Selimi, Sali Malsiu, Hafize Sallahi, Suhad Dullovi, Pranvera Loku-Zharku dhe Ramadush Osmani), ndërkaq nga zyrtarët e komunës ishte, zyrtarja për informim, Fatlume Guri, zyrtari për marrëdhënie me publikun, Festim Neziraj dhe 1 zyrtar për punë teknike.

Në këtë mbledhje morën pjesë edhe:

Ish Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Ilaz Ramajli,

Ish Kryetari i Komunës së Kaçanikut, Tahir Çaka.

Nga OJQ- 2 përfaqësues; Rrustem Dema dhe Kijani Zeneli.

Mbledhja mbahet për ndër të datave të shënuara 5, 6 dhe 7 Mars "Epopeja e UÇK", në përkujtim të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jasharit dhe rënies heroike të Familjes Jashari.

Mbledhjen e Kryesoj, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit,

Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare për punë të KK.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli. Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës, i nderuar Kryetar i Komunës së Kaçanikut, z. Besim Ilazi, të nderuar anëtarë tjerë të Ekzekutivit të komunës, të nderuar përfaqësuesit të organizatave të dala nga lufta e UÇK-së, i nderuari z. Ilaz Ramajli – ish Kryetar i Kuvendit të Kosovës, i nderuari, z.Tahir Çaka -ish Kryetar i Komunës së Kaçanikut, duke zbatuar të drejtën tonë, në zbatim të thirrjes nga agjenda shtetërore me rastin e shënimit të 24 vjetorit të Epopesë së UÇK-së, jemi mbledhur në këtë mbledhje Solemne si Kuvend i Komunës, për të shënuar këtë datë, njëra nga datat me të rëndësishme të historisë tonë. Kur kujtojmë ngjarjet si kjo, njëkohësisht kujtojmë dhe nderojmë të gjithë ata të cilët ranë në altarin e lirisë. Me këtë rast, kujtojmë dhe nderojmë sakrificën sublime dhe të pasembullt të familjes Jashari dhe Komandantit Legjendar, Adem Jashari. Andaj kërkojmë t'i nderojmë me një minutë heshtje. Pas mbajtës së një minutë heshtje, u fillua me agjendën e mbledhjes:

Agjenda

1. Fjala e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Kemal Murseli;
2. Fjalimi i Kryetarit të Komunës, Besim Ilazi;
3. Fjalimi i përfaqësuesve të grupeve parlamentare të Kuvendit të Komunës; dhe
4. Fjalimi i përfaqësuesit të shoqatave të dala nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës-UÇK-së.

Në vazhdim në përkujtim të ngjarjeve të shënuara, fjalën e morën sipas Agjendës:

1. Fjala e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Kemal Murseli;
2. Fjalimi i Kryetarit të Komunës, Besim Ilazi;
3. Fjalimi i përfaqësuesve të grupeve parlamentare të Kuvendit të Komunës;

Nga Subjektet politike të përfaqësuara në KK, fjalën e morën:

- Nga Subjekti Politik i PDK, shefja e GP, Fitore Vishi,
- Nga Subjekti politik i LVV, shefi i GP, Agim Mani,
- Nga Subjekti politik i LDK, shefja e GP, Arditra Rahmani,
- Nga Subjekti Politik i AAK, Rabije Sallahi,
- Nga Subjekti politik i NISMA, Agim Çaka.

4. Fjalimi i përfaqësuesit të shoqatave të dala nga lufta e Ushtria Çlirimtare e Kosovës-UÇK-së;

Nga shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së fjalën e mori, Tahir Çaka.

P. S. Fjalimet sipas radhitjes nga 1-8, do t'i bashkëngjiten Procesverbalit, dhe të njëjtat janë pjesë përbërëse e tij.

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryesuesi i Kuvendit kërkoj nëse donë kush tjetër të merr fjalën. Unë bisedova me herët edhe me z. Ilaz Ramajli për me marrë fjalën, por i njëjti tha se nuk mundem. Atëherë meqë nuk ka kush tjetër që donë me marrë fjalën, iu falënderoj të gjithëve për pjesëmarrje, shihemi në mbledhjen vijuese të KK.

Mbledhja i përfundoj punimet në ora 9:40.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

JMalsiu



Të nderuar anëtarë të Kuvendit, I nderuar kryetar, të nderuar drejtorë, pëfaqsues të shoqatave të dala nga lufta e UÇK së, ~~pëfaqsues~~ të Bashkësisë Islame të nderuar të pranishëm. *Indemnac Baca ilot, Baca qyt. Tahir.*

Duke ushtruar të drejtën tone dhe duke zbatuar thirrjen nga Agjenda Shtetërore me rastin e shënimit të 24 Vjetorit të Epopesë së UÇK se jemi mbledhur në këtë mbledhje solemne edhe ne si Kuvend komunal në Kaçanik për të shënuar këtë date apo më mire të themi njëren nga datat më të rëndësishme të Historisë tone të lavdishme.

Kur kujtojmë ngjarje si kjo, njëkohësisht kujtojm dhe nderojmë gjithë ata të cilët ranë në altarin e lirisë, e në këtë rast kujtojmë dhe nderojmë sakrificën sublime dhe të pasembullt të familjes Jashari dhe komandantin legjendar Adem Jashari. Andaj kerkojm ti nderojm me një minut heshtje.

Lavdi

Sot nderojme dhe kujtojme njerëz nder ngjarjet me te ndritura te Historise tone me te re, sakrificen e familjes Jashari, nderojme dhe përkulemi para Komandantit legjendar Adem Jashari dhe gjith bijve dhe bijave të Kombit të cilët me gjakun e tyre vunë themellet mbi të cilat sot qëndron Liria jonë, Pavarsia jonë dhe shteti i Kosovës.

Qëndresa heroike e Komandatit Adem Jashari dhe familjes së tij në datat 5,6 dhe 7 mars të vitit 98 paraqet rast te pasembullt në historin e njerzimit për tu bërë udhërrëfyes i përjetshëm për ne dhe brezat qe vijnë pas nesh.

Sakrificaifcat shekullore të popullit tone dhe Lufta e Lavdishme e UÇK se ndërgjegjesuan e bashkësisë ndërkombtare e cila në kuadër të NATOS te prie nga SHBA bombarduan Forcat Serbe duke i detyruar të largohen nga trojet tona.

Nga qarqe dhe mekanizma të ndryshëm nga brenda dhe jashtë , në të kaluarën edhe tani u tentua që të njolloset Lufta e UÇK se , tentative kjo që qdo dit e me shume po deshmohet se jane gatuar ne kuzhinat e Beogradit

Pastërtia e luftës tone u deshmua shume here në procese te montuara gjyqesore , do të dëshmohet edhe tani në procesin e fundit gjyqesor në Hagë.

Lufta e UÇK se , sakrifica e familjes Jashari dhe shumë familjeve tjera anekënd Kosovës deri në vetflijim , sollën lirinë e shumëpritur për këtë popull të shumëvaujtur ndër breza .

Ne të gjallëve na mbetet që ti kujtojmë qdo here heroizmat e e tyre , sepse ata do të jetojnë bashkë me ne deri sa ne ti kujtojmë.

Ne si institucione e kemi obligim për të punuar dhe zhvilluar vendin tone , sepse ishte amanet nga e kaluara dhe është obligim për brezat qe vijnë pas nesh .

Momentet e këtilla si sot duhet të na sherbejnë për ti bashkuar forcat si komb për ti quar perpara proceset me rendesi jetike per popullin tone sepse ky ishte amanet I gjithë të rënëve sepse edhe pse sot ne gjëzojmë lirinë dhe pavarësinë aspiratat e pushtuesve ndaj vendit tone nuk janë shuar .

Duke nderuar dhe kujtar jetën dhe vepren e gjithë atyre që ranë në altarin e lirisë ne nderojmë veten dhe përcjellim mesazhin tek brezat e rinjë se lirinë që e gjëzojmë sot nuk na e solli askush. por u fitua me gjakun e derdhur te bijve dhe bijave me te mire te kombit :

Lavdi e perjetshme Komandatit legjendar Adem Jashari dhe gjithë atyre që ranë për të na sjell lirinë .

I nderuar Kryesues i Kuvendit Komunal, të nderuar delegat, staf ekzekutiv, përfaqësues nga OSBE-ja dhe ju mysafir të tjerë të pranishëm

Jemi mbledhur sot, për të shënuar një ngjarje, për ti dhënë nderim, respekt e përkulje të përhershme historisë së lavdishme, të krijuar me Komandantin Legjendar Adem Jashari.

Në këtë ditë kujtojmë sakrificën më sublime të një familje, e cila bëri histori dhe jehonë kudo nëpër botë. Po, Familja Jashari, është një rast unikat në historinë e luftës, një familje e bashkuar, stoike me një qëllim të përbashkët- deri në fryshtë e fundit për të mbrojtur atdheun. Rrallë herë kemi dëgjuar dhe do të dëgjojmë për një sakrificë të tillë, kaq të madhe për mbrojtjen e atdheut. Ishte familja Jashari ajo që krijoi Epopenë e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ishte kjo familje që na motivoi mijëra djem e vajza që të marshojnë rrugës së UÇK-së, të mbrojnë atdheun deri në çlirim.

Epopeja e UÇK-së mbetet ngjarja më Krenare e historisë së Kosovës, ditët 5, 6 dhe 7 mars, janë ditët që shënuan sakrificën sublime, të një familje heroike, e cila për tri ditë radhazi, u bëri ballë sulmeve të fuqishme të armikut, ishin tri ditë që mbushën flakë Kullat e Jasharajve, por në këto kulla, burra, gra e fëmijë, luftuan e kënduan deri në fryshtë e fundit, me një qëllim e ideal të përbashkët.

Kanë kaluar mbi dy dekada që nga ajo kohë, por Jehona dhe piedestali i kësaj ngjarje, na bëjnë krenar dhe janë fryshtëzim për jetën e tashme dhe të ardhmen tonë, për punën dhe angazhimin institucional që kemi secili para vetes, për një të ardhme më të mirë për brezat që do të vijnë, sepse kjo tokë, kjo liri e ky shtet u ndërtua mbi sakrificën e gjakun e familjes Jashari dhe qindra e mijëra dëshmorë, invalid e veteran të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Këtë ditë, ne nderojmë edhe Komendant Agim Bajramin e Qamil Ilazin, nderojmë edhe të gjithë heronjtë, dëshmorët dhe martirët, të cilët nuk kursyen jetën për të realizuar një endërr që është bartur tek ne brez pas brezi – Lirinë!

Lavdi e përjetshme për ju që nuk kursyet asnjë nga vetja që ne sot të fryshtëm lirë.

Ju faleminderit

Fjalimi i Fitore Vishi, shefe e GP të PDK-së

I nderuar z. Kryetar, Te nderuar: z. Nënkyretar, z. Kryesues, kolegë dhe kolege të Kuvendit të Komunës, drejtore dhe zyrtarë, të pranishëm të kësaj seance solemne kushtuar Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,

E autorizuar të marr fjalën, para së gjithash me përkulje e në kujtim të përhershëm të dëshmorëve dhe të të gjithë atyre që ranë në altarin e lirisë, do të më lejoni pra që të shpreh një dy-tri fjalë:

- Lëvizja kombëtare e Kosovës për çlirimin nga okupatori, përbën ngjarje e kapituj të dhembshëm, sa edhe të lavdishëm e heroikë. Në të vërtetë, edhe si tërë historia jonë. Ndërkohë që fryma rezistuese, aktet dhe veprimitaria patriotike përgjatë viteve të '90-ta të shekullit të kaluar, nën kushtet dhe rrethanat e pjkura të brendshme e të jashtme, aso kohe përfundimisht kulmuan edhe me një kualitet të ri – me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, e njohur botërisht.

Kur rikthehemë në lëvizjen, në ngjarjet e në proceset e asaj dekade, përvëç në veprimtarinë e përgjithshme e të pandalshme atdhetare, në dënimet e në vrasjet që i bëheshin popullit, kujtesa na çon pikërisht edhe në vitin 1991, kur pushteti okupator serb, në vazhdën e përndjekjeve, ishte lëshuar egërsisht edhe kundër disa grupeve nga Kosova, që kishin kryer stërvitje ushtarake në Shqipëri dhe jo vetëm ndaj tyre. Ndërkohë që, në mëngjesin e 30 dhjetorit po të vitit 1991, forca të shumta policore-serbe rrrethojnë edhe Prekazin dhe familjen Jashari, porse Familja Jashari u përgjigjet me armë. Sepse, kjo familje atdhetare asgjë nuk po i linte rastësisë. Sikundër që, mbi këtë familje, sulm i përsëritur i armikut ka ndodhur po ashtu edhe më 22 janar 1998. Por që, përkundrazi, me përgatitjet që më parë, kjo familje, jo vetëm që dëshmoi gatishmërinë kundër okupatorit, por me rezistencën e saj fuqizoi shprehimisht shpresën e lirisë në Kosovë. Duke i paraprirë edhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, organizimit të mëtejshëm dhe lindjes së saj, më 28 nëntor 1998, guximshëm edhe në sytë e botës: në ditën e varrimit madhështor të mësuesit të vrarë nga okupatori, mësuesit Halit Geci; UÇK! – e brohoritur aty, e cila lindi si një betim e kushtrim i ndritshëm e i përflokur për liri.

Prandaj, edhe sot, në **paradritën** e Natës së Zjarreve – mishërim përkujtimor i Betejës së familjes Jashari të Prekazit, më 5, 6 e 7 mars 1998, përkatësisht të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në 24-vjetorin e saj, nuk mund të themi veçse që kjo familje emblematike shqiptare, me betejën epike dhe unike të saj, tashmë jo vetëm shpresa, por ishte lartësuar në besimin më të shenjtë popullor për fitoren e pashmangshme të lirisë. Koha e ka provuar këtë, populli shkaktar, në ballë me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, miqësisht dhe ushtarakisht përkrah me SHBA dhe Aleancën e NATO-s.

Dhe, jo vetëm si fill epik i UÇK dhe besim i patundur në fitore, por Familja Jashari në atë betejë, në ndeshjen luftarake: një familje – me një ushtri shtetërore!, ku rrëth 60 anëtarë të Familjes Jashari bien në altarin e lirisë, ishte rilindur edhe si një Kult i Diellit për ne.

Prandaj, jo rastësisht, edhe Administratori i parë ndërkombëtar në Kosovën e lirë, francezi Bernard Kushner, pati thënë: "Po të kishte çmim Nobel për liri, ai do t'i takonte Adem Jasharit dhe familjes së tij!"

Ndaj, me të drejtë mund të themi se Epopeja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me Kryekomandantin Adem Jashari, përcaktoi luftarakisht fitoren e lirisë, drejt shtetësisë dhe pavarësisë së Republikës së Kosovës, me synim edhe integrimin e mëtejshëm kombëtar e ndërkombëtar.

Lavdi Heroit Legjendar Adem Jashari!

Lavdi heronjve, dëshmorëve dhe gjithë të rënëve për liri!

Ju faleminderit!

Fjalë Përshëndetëse

FJALA: Epopeja e UÇK-së na kujton sakrificën e Familjes Jashari për Lirinë dhe Pavarësinë e Kosovës

Në këto ditë, ne si asnjë herë më parë, e ndjejmë frymëmarrjen e lirë dhe e kujtojmë se sa e rëndësishme ishte për ne lufta çlirimtare, se sa të rëndësishëm ishin për ne ata djem trima që morën armët dhe nuk pranuan peshën e rëndë të robërisë!

Kujtojmë me respekt dhe krenari veprat dhe sakrificën e Familjes Jashari në krye me Komandantin Legjendar Adem Jashari që luftuan dhe u sakrifikuani për Lirinë dhe Pavarësinë e Kosovës.

Jeta dhe vepra e tyre duhet tëjenë shembulltyrë përgjithësive, dhe gjithë brezat që do të vijnë.

“Epopeja e UÇK-së” është ngjarja me të cilën për tri ditë me radhë 5,6,7,Marsi kujtojmë komandantin legjendar Adem Jashari dhe familjen e tij, “Ata me veprimet dhe organizimin dhe qëndresën e palëkundër të tyre e kishin thënë shumë hera:më e shtrejtë është liria se sa jeta. ”.

Sulmin e gjërë që e kishte ndërmarrë Serbia në Drenicë përtë zhdukur Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës e kishte koncentruar në Prekaz, në zemrën dhe kokën e UÇK-së, duke i bërë asaj një rrëthim të hekurt.

Ajo që ka ndodhur në fillimet e marsit të vitit 1998 do të jetë një dëshmi e gjallë përbotën e qytetëruar dhe përgjegjësit e saje politike e diplomatike.

Në të vërtetë kjo ngjarje kaq e drejtpërdrejtë dhe kaq e fuqishme për nga përmasat e saj të flijimit unikat, të qëndresës e të masakrimit e ka ngritur çështjen e Kosovës në krye të agjendës botërore. Sulmi , që ka ndodhur më 5, 6 dhe 7 mars të vitit 1998 u ka marrë jetën e 59 dëshmorëve,ku në mesin e tyre kishte ,burra,gra dhe fëmij

Këtij sulmi i ka mbijetuar vetëm Besarta, vajza e Hamzës, e cila ka parë dhe përjetuar tmerrin, derisa ishin duke u vrarë anëtarët e familjes së saj! Të cilët nuk kursyen jetën për të realizuar një ëndërr që është bartur tek ne brez pas brezi!

Pikërisht, më 5 mars bëhen 24 vite të rënies së komandantit legjendar, Adem Jasharit, familjes së tij dhe të tjerëve të rënë.

Mirëpo, çdo përvjetor I Epopejes se UCK-së e bënë më të lavdishëm historinë e kombit tonë. Me aktin e rënies së komandantit legjendar Adem Jasharit, familjes së tij dhe Jasharëve të tjerë, Kosova mundi frikën me çka i hapi shtigjet e lirisë dhe të ardhmërisë.

Dhe jo rastësisht, në Prekaz, në Lagjen e Jasharëve është ngritur monumenti më i madh i luftës për liri, për pavarësi e demokraci, që këto ditë, e pikërisht 5, 6, 7 mars për çdo vit vëmendja e të gjithë kombit shqiptar kthehet nga Prekazi Legjendar.

Historia e familjes Jashari dhe eksponatet e saj janë vendosur në Muzeun e Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

.

Rënia e komandantit legjendar, I shtyen në mobilizim Shqipëtarët, dhe bashkoi pupullin kundër një armiku siq ishte Sërbia e cila deshi të na gjejë të ndarë dhe të përqarë për luftë.

Rënia e familjes Jashari, pati jehonë të madhe edhe në mbarë botën demokratike dhe liridashëse. Në vend që të vdes Adem Jashari, ai u bë i gjallë. Rënia e tij, u bë thirrje për luftë dhe kësaj lufte ju bashkuan të gjithë shqiptarët.

Luftha filloi të zgjerohej në tërë vendin. Kësaj thirrjeje, ju përgjigj edhe Komuna e Kacanikut, fillimisht u organizuan në njësi të ndryshme të

3

Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilat më pas u sistemuan në brigade. Në krye të kësaj brigade ishte komandanti I parë I kësaj brigade “Agim Bajrami” I pasuar nga Komandanti Qami Ilazi. Edhe shumë djem e vajza, pleq e të ri, ju bashkuan këtij mobilizimi të luftës për liri, ku pothuajse çdo shtëpi ishte në shërbim të luftës çlirimtare. Kacaniku, i dha shume dëshmorëve Kosovës. Këtu u zhvilluan beteja të ashpra, të cilat lanë gjurmë të pashlyeshme në historinë e kombit tonë.

Lirinë që e gjëzojmë sot, e kemi nga dëshmorët e kombit, martirët, dhe mbi të gjitha nga familja Jashari, dhe faktorët tjerë ndërkombe të që është Nato-ja dhe ndërhyrja e saj kundër Jugosllavisë, dhe me pas kontributet e të tjerëve të gjithë neve që mbeten të gjallë.

Këta nuk na lënë të harrojmë as të gabojmë, ata e kanë kryer punën e vet më të madhe. Falë tyre ne kemi institucione, kemi shtet, Liri dhe Pavarsi, ndonëse ende jo ashtu siq ata deshën, e për qfar ata u flijuan, dhe na tregojne se rruga jonë ende nuk ka mbaruar.

Të nderuar të pranishëm, Ne të gjithë jemi krenarë që i kemi takuar kësaj gjenerate, që na u dha mundësia të luftojmë për vendin.

Lufta për atdheun është krenari. Të flijohesh për atdheun, është akti më sublim që mund të bëhet, e këtë e bënë Adem Jashari, familja Jashari dhe të gjithë dëshmorët e kombit dhe te tjeret. 5, 6 dhe 7 marsi, janë ditët më të lavdishme.

Kjo është “Epopeja e lavdishme e UÇK-së”. LAVDI Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij! Lavdi të gjithë dëshmorëve të kombit!

Fjalimi i Arditë Rrahmani, shefe e GP të LDK

Inderuar kryetar i komunës,
 Inderuar kryesues i kuvendit,
 Inderuar z. Ramajli, z. Çaka
 Ekzekutiv i komunës,
 Inderuar përfaqësues i Organizatave të dala nga Lufta,
 Familje të dëshmorëve,
 të nderuar kolegë asambleist,
 qytetarë dhe gjithë ju të pranishëm.

“Te gjithë dhanë diçka, por dikush i dha te gjitha”.

Nuk ka shprehje tjetër që mund te e përshkruaj me mirë dashurinë për atdheun.
 Nuk ka shprehje tjetër as që e tregon çmimin e lirisë.

Ditët e lavdisë se përjetshme të trasuar deri me vetëflijim janë ditët me të cilat sot mburremi para vetes e karshi botës se sa e lavdishme ishte lufta e jonë kundrejt okupatorit ogurzi.

Ideali i çlirimit te atdheut ishte emëruesi i përbashkët i ushtarëve, heronjve e veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare te Kosovës, emërues ky që që u bë krenari e çdo shqiptari kudo që jeton e flet shqip.

Flijimi i familjes Jashari nuk është unik vetëm ne historinë e kombit shqiptar, ajo vazhdon të mbetet unike edhe ndër kombe të tjera, sepse ishte ky akt që frymëzoi me mijëra të ri e të reja që ti bashkohen radhëve të Ushtrisë Çlirimtare te Kosovës.

Emri i Adem e Hamzë Jasharit, u bënë busullë orientimi drejt konsolidimit të shtetit me të ri në botë, dhe referencë e frymëzim brezash tash e 24 vite.

Lavdi dhe përjetësi për komandantin Adem Jashari, familjen e tij dhe gjithë dëshmorët e kombit.

Inderuar Kryetar I Komunes ,
Inderuar Kryesues I Kuvendit ,
Te nderuar Drejtore , kolege asambleiste ,
Inderuar z.Ramajli , z.Caka ,
Te nderuar perfaqesues te OVL-UCK-se ne Kacanik ,
Si dhe ju te pranishem ne kete séance solemne .

Tri dite te muajit Mars jan ato dite qe neve na kujtojne tere sakrificen e popullit shqiptar , Marsi eshte ky muaj qe me se miri tregon historine tone kosovare .

Epopeja e lavdishme e UCK-se eshte ngjarje historike per Kosoven .

Per tri dite me radhe kujtojme Komandantin legjendar Adem Jashari , si dhe familjen e tij te cilet dhan jeten e tyre dhe u sakrifikuani per lirine e ketij vendi .

Ne kete dite nderojme dhe kujtojmw te gjithe heronje , deshmoret dhe martiret te cilet nuk kursyen jeten etyre per nje enderr te quajtur "Liri " .

Figura e Adem Jasharit bashke me ngjarjet e 5/6/7 Marsit perbejne teresine e sfidave qe per kohen ishin nje ndryshim Epoke .

Lavdi Familjes Jashari !

Lavdi te gjithe deshmoreve dhe martireve te Kosoves !

EPOPEJA E UÇK-së

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

I nderuar ish kryetar i Kuvendit të Kosovës z. Ilaz Ramajli,

I nderuar ish kryetar i komunës z. Tahir Çaka,

Të nderuar përfaqësues të veteranëve të UÇK-së,

Të nderuar kolegë asambleist,

Të nderuar gjithë ju të pranishëm,

Datat 5,6 dhe 7 Mars janë data të cilat do të përkujtohen gjeneratë pas gjenerate sepse pikërisht këto data lidhen me një nga ngjarjet me të rëndësishme në historinë e popullit shqiptar e sidomos popullit shqiptar në Kosovë, Epopenë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në një kohë kur ishin shteruar të gjitha mundësitë për zgjidhje paqësore të problemit të Kosovës normalisht që bijtë dhe bijat tonë të cilët nuk e kishin pushuar aktivitetin e tyre për realizimin e qëllimit përfundimtar kishin filluar të mendonin ne opsonin e fundit për një luftë të armatosur ndaj një kundërshtari shumëfish më të fortë e që në mendjen e tyre kishin vetëm dy mundësi: Ja vdekje Ja liri.

Në këto rrethana kishin filluar rrëth këtij sloganit të bashkoheshin të gjithë ata të cilët ishin te vetëdijshëm se në një luftë kaq të pabarabartë, shumë me të sigurt e kishin vdekjen se sa që do ta shijonin lirinë por që ishin shumë të sigurt se nëse jo ata, pasardhësit e tyre do të jetonin në një shtet të lirë për të cilin në forma të ndryshme kishin punuar e vepruar edhe shumë gjenerata para tyre.

Fakti qe ata ishin shumë të sigurt se përpara mund të vriteshin se sa të mbijetonin, nuk I ndali ata e as nuk i zmbrapsi nga vendosmëria për të luftuar për liri deri në vdekje.

Për ne që ishim dëshmitarë dhe veprimtare të kohës këto data na kthejnë në një kohë sa të vështirë po aq edhe të lavdishme.

Kujtojmë kohën kur çdo ditë e më tepër masat e represionit rritheshin. Largime nga puna, largime të nxënësve nga shkollat, rrahje e keqtrajtime, montime të rasteve me qëllim të iniciimit të persekuimeve, pasiguria e daljes se qytetarëve në rrugë, më në fund Kosova kishte marr pamjen e një burgu kolektiv dhe gjithnjë e më shumë me ngjyra të një robërie të plotë.

UÇK, ishin tri shkronja shprese të cilat I bënин me dije edhe faktorit të brendshëm edhe faktorit të jashtëm se ky popull ka ushtrinë e vet e cila as nuk ishte parë dhe as nuk ishte njojur me parë por që kur e kërkonte momenti shfaqeje, kryente detyrat dhe tërhiqej në bazën e saj të padukshme për armikun.

Çdo ditë sulme në forcat armike, në objekte dhe njerëz.

Dëme dhe pasiguri në lëvizjet e tyre

Çdo ditë e më shumë mobilizim dhe masivizim në radhët e UÇK-së

Këto ishin shpresa dhe shenjat se lufta po fillonte dhe rruga drejt lirisë ishte e qartë.

Fundi I vitit 97, viti 98 dhe fillimi I vitit 99 ishin vitet më të vështira, të përcjelluara me luftime të përgjakshme, ku u bashkuan ushtria dhe populli me një qëllim të përbashkët. Populli ruante ushtrinë dhe ushtria ruante popullin.

U bënë shumë aksione luftarake, armiku dobësohej gjithnjë e më shumë si në aspektin material ashtu edhe moral.

Në anën e Ushtrisë Çlirimtare te Kosovës rreshtohet edhe forca më e madhe e aleatëve NATO dhe ky ishte momenti vendimtar që u vendos vula e lirisë së Kosovës .

Pra këto ishin vitet e Epopesë së UÇK-së të cilat do të kujtohen brez pas brezi.

Këto data na kujtojnë Komandantin legjendar Adem Jashari dhe sakrificën e familjes Jashari te cilët shkuan ne vetëflujim kolektiv.

Na kujtojnë Ushtrinë Çlirimtare te Kosovës, daljen e saje publike

Na kujtojnë luftën heroike të pjesëtarëve te UÇK-së

Na kujtojnë shumë dëshmorë anekënd Kosovës.

Na kujtojnë shumë plagë dhe gjak te derdhur te Veteranëve të UÇK-së

Na kujtojnë shumë viktima civile.

Na kujtojnë shumë vuajtje dhe sakrifica

Dhe, më në fund na kujtojnë neve që përjetuan këtë kohë dhe gjeneratat e reja që nuk e përjetuan këtë kohë se Lirinë nuk na I fali kush, e fituam me gjak normalisht me ndihmën e aleatëve dhe se shteti që kemi sot është rezultat I sakrificës që u bë dje dhe se ky shtet duhet në rend te parë të duhet, të respektohet e të punohet për te çdo dit e me shumë dhe në fund secili prej nesh ti drejtohet vetes me pyetjen:

Çka bëra unë për shtetin e jo çka bëri shteti për mua.

Lavdi familjes Jashari!

Lavdi komandantit legjendar Adem Jashari!

Lavdi dëshmorëve ndër breza!

Respekt për luftën e UÇK-së

Respekt familjeve te dëshmorëve!

5 Mars 2022

Agim Çaka, Nisma socialdemokrate

Kaçanik

4.Fjalimi i përfaqësuesit të shoqatave të dala nga lufta e Ushtria Çlirimtare e Kosovës-UÇK-së;

z. Tahir Çaka, Faleminderit Kryesues, Meqenëse unë po përfaqësoj shumë OJQ të dala nga lufta e UÇK-së, atëherë me lejoni që zoti kryetar i komunës Besim Ilazi, anëtarëve të Kuvendit të Komunës, Drejtoreve të drejtive komunale, kryetarin e SHIL, Rrustem Dema, ish kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Ilaz Ramajli. Me lejoni që në emër të organizatave të dala nga lufta e UÇK-së t'i përshtendes të gjithëve, njehë rit e falënderoj kryesuesin e KK dhe Kryetarin e komunës për organizimin e kësaj seance. 5.6 dhe 7 marsi shënojnë ditën e epokës së Ushtrisë çlirimtare të Kosovës, Ditën kur komandanti legjendar UÇK-së, Adem Jashari dhe familja Jashari u sakrifikuani përlirinë, pavarësinë dhe bashkimit kombëtar. Lufta heroike e komandantit legjendar dhe familjes Jashari, është ndërë dhe lavdi e kombit, prandaj duke iu falënderoj të gjithëve juve, me keni habitur pakëz përdiskutimet e grupeve parlamentare se me keni habitur me fjalimet e juve. Për fund, Lavdi dëshmorëve të kombit, lavdi komandantit legjendar, Adem Jashari, Zoti e bekofte familjen Jashari.

REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
(të zgjedhur në votimet e datës 17 Tetorit 2021);

Nga Mbledhja e II (Dytë) Solemne e Kuvendit të Komunës për vitin 2022, mbajtur me 05 Mars 2022:

1. Kemal Murseli, *Durç*,
2. Brahim Imishti....., *Mishti*,
3. Hamide Luma , *Hamide*,
4. Kadri Krivenjeva , *Kadri*,
5. Fitore Vishi,....., *Vishi*,
6. Rrustem Zenuni,....., *Zenuni*,
7. Edon Baftiu, *Baftiu*,
8. Selajdin Troni, *Selajdin*,
9. Fatmir Bunjaku, *Fatmir*,
10. Bashkim Krasniqi, *Bashkim*,
11. Florina Lika-Vishi, *Florina*,
12. Lejla Muhamheri-Çaka....., *Lejla*,
13. Agim Mani, *Agim*,
14. Kadrije Lika-Troni, *Kadrije*,
15. Adnan Reka, *Adnan*,
16. Naim Beça, *Naim*,
17. Raif Kasa, *Raif*,
18. Ernesta Krasniqi,....., *Ernesta*,
19. Bashkim Luma, *Bashkim*,
20. Arta Avdiu, *Arta*,
21. Ardita Rrahmani, *Ardita*,
22. Besnik Salihu, *Besnik*,
23. Betim Shala,....., *Betim*,
24. Arlinda Rakoci-Raka....., *Arlinda*,
25. Rabije Sallahi....., *Rabije*,
26. Ekrem Livoreka....., *Ekrem*,
27. Agim Çaka....., *Agim*.